

AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“AVIEL INTERNATIONAL CORPORATION” Sh.p.k.

Ne Tirane, sot me date 17 Qershor 2024 u mblodh Asambleja e Ortakut te Vetem te Shoqerise me prezencen e Ortakut te saj z. **Fation Kolaj**, shtetas shqiptar, i biri i Pjetrit dhe Dukates, lindur ne Midhë, Pukë me 21 Prill 1988, banues ne Tirane, ne adresen: Rruga Teodor Keko, Nr Pasurie 215/87/, Nd 4, Nr 17, madhor me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet dokumentit te identifikimit me nr personal I80421049D, i cili me cilesine e “ortakut themelues” redaktoi kete Akt Themelimi, nepemjet te cilit deklaroi se me vullnet të lire të plote e të singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin nr 9901 date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, i ndryshuar me ligjin nr 129/2014 date 01.10.2014, ne ligjin nr 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Biznesit”, i ndryshuar me ligjin nr 131/2015 date 26.11.2015, ne legjislacionin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar **“AVIEL INTERNATIONAL CORPORATION” shpk.**

KREU I

Neni 1
Krijimi

1.1 Shoqeria, **“AVIEL INTERNATIONAL CORPORATION” shpk.** eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

2.1 Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me legjislacionin Shqiptar ne fuqi.

2.2 Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

2.3 Shoqeria **“AVIEL INTERNATIONAL CORPORATION” shpk.**, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në pjese dhe që themelohet nga ortaku që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3
Selia

3.1 Shoqeria e ka seline ne Tirane ne Adresen: Rruga Teodor Keko, Nr Pasurie 215/87/, Nd 4, Nr 17, Tiranë

3.2 Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Vetem te Shoqerise.

Neni 4
Kohëzgjatja

4.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore **te pakufizuar**, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.



Neni 5
Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarise se Shoqerise “**AVIEL INTERNATIONAL CORPORATION**” shpk perfshin:

- 5.1 Ne fushën e logjistikës, transportit, ndërmjetsimit tregtar,
- 5.2 Ne rolin e agjentit për palë të treta, lidhur me pasuri të luajtshme dhe paluajtshme;
- 5.3 Ne fushën e shërbimeve të tjera të ngjashme me prezencë fizike dhe me përdorim on-linë të platformave të automatizuara, IA.,
- 5.4 Në përgjithësi, Shoqëria mund të kryej çdo veprimtari të nevojshme e të dobishme, të lejuar nga ligji për realizimin e objektit të aktivitetit të saj.

KREU II
KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 250 000 000 (dyqindee pesedhete milion) lekë, i ndare në 1 (nj) pjesë , vlere nominale e të cilit eshte 250 000 000 lekë.
- 6.2. Kapitali i Shoqerise zoterohet plotesisht nga ortaku themelues i ndare ne nje pjese me pjesemarrje:
 - 6.2.a z. **Fation Kolaj**, zoteruese e 1(nje) pjese ose 100% te kapitalit te nenshkruar te shoqerise,
- 6.3 Kapitali i mesiperem eshte nënshkruar dhe do te shlyet tërësisht ne te holla nga ortaku i shoqerise “**AVIEL INTERNATIONAL CORPORATION**” shpk, nepermjet transfertes bankare, kuota me vlere te pergjithshme 250 000 000 lekë, qe perbejne 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.
- 6.4 Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlere të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.
- 6.5 Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;


Neni 7
Transferimi i kapitalit

- 7.1 Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Ortakut te Vetem te Shoqerise.
- 7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve nepermjet akteve ligjore.

KREU II
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organi Vendimmarres

- 8.1 Asambleja e Ortakut te Vetem te Shoqerise eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.
- 8.2 Asambleja e Ortakut te Vetem te Shoqerise eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise



qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

8.3 Asambleja e Ortakut te Vetem te Shoqerise brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori,

8.4 Asambleja e Ortakut te Vetem te Shoqerise mund të përfaqësohet edhe nga një tjetër person, nepermjet prokures.

Neni 9

Ndryshimet e Statutit

9.1 Ndryshimet e statutit vendosen nga Asambleja e Ortakut te Vetem te Shoqerise.

9.2 Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 10

Administrimi

10.1 Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asambleja e Ortakut te Vetem te Shoqerise.

10.2 Asambleja e Ortakut te Vetem te Shoqerise vendos per sistemin e administrimit, dhe ne rastin e nje organi administrativ me shume administratore, percakton numrin e tyre dhe kompetencat.

10.3 Administratori/ret, mund te jene ose jo ortake.

10.4 Administratori/ret mund te shkarkohet ne cdo kohe.

10.5 Shoqeria do te funksionoj me nivel nje Administratori

10.6 Administrator i shoqerise eshte:

10.6.a **z. Fation Kolaj**, shtetas shqiptar, i biri i Pjetrit dhe Dukates, lindur ne Midhë, Pukë me 21 Prill 1988, banues ne Tirane, ne adresen: Rruga Teodor Keko, Nr Pasurie 215/87/, Nd 4, Nr 17, madhor me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet dokumentit te identifikimit me nr personal I80421049D

10.7 Administratori i shoqerise do te ushtrojne komptencat e tij ne kete detyre per nje periudhe 5 (pese) vjecare.

Neni 11

Kompetencat

11.1 Shoqëria administrohet nga nje Administrator. Administratori ka të drejte të kryejne të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.

11.2 Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve.

11.3 Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Ortakut te Shoqerise.

11.4 Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

11.5 Administratori ka gjithashtu të drejte të nënshkruaje kontrata të ndryshme në emër e për llogari te Shoqërisë, përfshi këtu kontratat e qirasë, shitjes, blerjes a hipotekimit të pasurive të paluajtshme, operacione financiare, të nënshkruajne aktet e themelimit të shoqërive të tjera ku Shoqëria është ortak, të nënshkruajne e hartojne çdo dokument e të kryejne në emër të Shoqërisë çdo veprim përballë të gjitha Bankave shqiptare apo te huaja në lidhje me çeljen apo mbylljen e llogarive rrjedhëse te Shoqërisë, nënshkrimin e kontratave te ndryshme bankare për financimin e Shoqërisë si dhe te kryeje veprime tërheqje e derdhje

shumash nga këto llogari pa limit.

11.6 Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

11.7 Klauzolat e këtij Akt Themelimi që kufizojnë kompetencat e administratoreve, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

11.8 Administratori ose Ortaku që nuk janë persona juridikë nuk u lejohej të kontraktojnë në çfarëdo formë qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 12
Viti Financiar

12.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

12.2 Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13
Shpërndarje, Likuidimi ose Prishja e Shoqërisë

13.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, edhe para plotesimit të afatit per të cilin është krijuar sic mund të jone :

13.2.a Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të metejshëm të veprimtarisë se saj.

13.2.b Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji " Per Falimentimin e Shoqërive Tregtare"

13.2.c Kur plotësohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

13.3 Ne kete rast Ortaku i Shoqërisë merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1(nje) apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqëri ne likuidim e siper " .

Neni 14
Baza Ligjore

14.1 Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

14.2 Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë qe ka lidhje me objektin e veprimtarisë se shoqërisë.

Neni 15
Dispozita përfundimtare

15.1 Ky akt themelimi u redaktua ne 3 (tre) ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues te shoqërisë "**AVIEL INTERNATIONAL CORPORATION**" shpk, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tyre orgjinale, autenticiteti i të cilit vertetohet nga dokumenti i identifikimit ketu bashkengjitur.

ORTAKU

Fation Kolaja

